

Aktgjykim në rastin Prokurori kundër Pjetër Shalës

Trupi gjykues¹ i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK), kryesuar nga gjyqtarja Mappie Veld-Foglia, më 16 korrik 2024 shpalli aktgjykimin në rastin *Prokurori kundër Pjetër Shalës*. Pjetër Shala u shpall fajtor për krimin e luftës kundër popullatës civile dhe u dënua me tetëmbëdhjetë (18) vite burgim për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme, kurse është liruar nga akuza për trajtim mizor si krim lufte.

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) e ka përcjell këtë proces gjyqësor, por në këtë fazë do të rezervohet nga komentimi i aktgjykimit të shkallës së parë për shkak të mungesës së qasjes në të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor. Një pjesë e madhe e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria janë dëgjuar në seancat e mbyllura, ku monitoruesit e FDHK nuk kanë pasur qasje. Gjatë monitorimit të gjykimeve për krimet e luftës, emri i të pandehurit është përmendur si i dyshuar dhe bashkëkryerës në dy procese të tjera gjyqësore, konkretisht në rastin *Prokurori kundër Sabit Gecit dhe të tjerëve* dhe në rastin *Prokurori kundër Xhemshit Krasniqit*, të cilat janë zhvilluar pranë gjykatave të Kosovës, ku aktakuzat janë ngritur nga prokurorë të misionit të EULEX-it. Në këto dy procese, gjykata ka shqiptuar dënime prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite burgim.

Fakte dhe Akuza²

Shala, si anëtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), akuzohej se midis periudhës 17 maj dhe 5 qershor 1999, bashkë me disa anëtarë të tjerë të UÇK-ës, kanë arrestuar/ndaluar në mënyrë arbitrare të paktën tetëmbëdhjetë (18) persona në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri. Sipas gjetjeve të gjykatës, të ndaluarit janë marrë në pyetje dhe janë keqtrajtuar rregullisht psikologjikisht dhe fizikisht dhe kanë jetuar nën frikën e vazhdueshme se mund të bëheshin objekt i keqtrajtimit fizik në çdo moment apo edhe mund të vriteshin. Njëri prej të ndaluarve, pas plagosjes me armë zjarri, një ditë më pas ka vdekur si pasojë e plagëve dhe e keqtrajtimit. Provat tregojnë se këta persona u arrestuan dhe u mbajtën të ndaluar me pretendime të mjegullta se ishin “tradhtarë” ose “bashkëpunëtorë” të autoriteteve serbe, simpatizonin Serbinë, ose nuk mbështesnin mjaftueshëm përpjekjet e UÇK-së, financiarisht, ushtarakisht apo politikisht. Të ndaluarit janë mbajtur në fabrikën e metalit prej disa ditë deri në një muaj.

Trupi gjykues konstatoi se Shala mban përgjegjësi penale individuale për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët, në formën bazë të saj.

¹Anëtarë të trupit gjykues Roland Dekkers, Gilbert Bitti dhe Vladimir Mikula (gjyqtar rezervë).

² Aktakuza kundër Pjetër Shalës është ngritur në datën 31 mars 2021.

Arrestimi dhe Procesi Gjyqësor

Pjetër Shala, i njohur me nofkën “Ujku”, u arrestua më 16 mars 2021 në Belgjikë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK më 16 prill 2021. Deri në tetor të vitit 2022 janë mbajtur shtatë (7) seanca mbi ecurinë e çështjes dhe dy (2) seanca përgatitore për gjykim.

Shqyrtimi kryesor filloi më 21 shkurt 2023 me paraqitjen e fjalëve hyrëse të palëve. Gjatë shqyrtimit kryesor dëshmuan njëzetë e dy (22) dëshmitarë: dhjetë (10) të propozuar nga prokuroria, dhjetë (10) nga mbrojtja dhe dy (2) nga mbrojtësi i viktimave. Nga dhjetë (10) dëshmitarët e propozuara nga prokuroria, shtatë (7) dëshmuan me masa të sigurisë në seanca të mbyllura për publikun, me identitet të fshehur.

Viktimat pjesëmarrëse

Në këtë çështje gjyqësore janë pranuar tetë (8) viktima pjesëmarrëse, viktimat ishin kryesisht shqiptarë të Kosovës, të cilët janë përfaqësuar nga mbrojtësit e viktimave gjatë shqyrtimit kryesor. Urdhri për zhdëmtim të viktimave do të publikohet së shpejti nga DHSK.

Sipas trupit gjykues, ky gjykim është zhvilluar në kontekstin e atmosferës së vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve. Kjo atmosferë ka pasur një ndikim të dukshëm, ndonëse në shkallë të ndryshme, në dëshmitë e dhëna nga disa prej dëshmitarëve, të cilët dolën para trupit gjykues.

Ky aktgjykim është i shkallës së parë, palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit “Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë” dhe nga organizata “National Endowment for Democracy” përmes projektit të quajtur “Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik”.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës “National Endowment for Democracy”.